



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:011688

Datë: 26.06.2024

Numri i dokumentit: 05861834

K.Dh.Sh.II.nr.983/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Avokat Labinot Vata me adresë në rr. “Bardhyl Qaushi” Kompleksi KAWA, Hyrja D, nr.1 Prishtinë, të cilin e përfaqëson Marigona Berisha, avokate nga Prishtina, kundër debitorit Komuna e Fushë Kosovës, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë -Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.964/23 të datës 10.01.2024, me datë 26.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Av. Labinot Vata me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson Marigona Berisha, avokate nga Prishtina, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë -Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 964/23 të datës 10.01.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë -Departamenti i për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr. 964/23 të datës 10.01.2024, në dispozitiv e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Fushë Kosovës, të ushtruar

kundër Urdhrit për Përmbaram P.nr.300/23 dt. 15.05.2023 të Përmbaruesit Privat Gëzim Baloku dhe i njëjti urdhër P.nr.300/23 dt. 15.05.2023 Anulohet.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale me propozim që gjykata e shkallës së dytë, aktvendimin e ankimuar ta ndryshoj dhe ta refuzoj prapësimin ose çështjen ta kthej në shkallë të parë në rivendosje.

Debitori nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaramore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Av. Labinot Vata me datën 15.05.2023, ka paraqitur propozimin për përmbaram mbi bazën e dokumentit përmbaramor, Marrëveshjes për ndërmjetësimin me numër 026/2022 e datës 27.12.2022, ka lejuar Urdhrin Përmbaramor P.nr. 296/23, të datës 15.05.2023, ndaj debitorit Komuna e Fushë Kosovës që në emër të detyrimit që rrjedh nga marrëveshja e lartcekur, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 312.00 EUR (me shkronja: treqind e dymbëdhjetë) me kamatë vonesë 8% e nga dita e lejimit të këtij propozimi deri në pagesën definitive, shpenzimet e procedurës përmbaramore në vlerë prej 117.00 euro si dhe të gjitha shpenzimet tjera që do të krijohen në këtë procedurë.

Përmbaruesi Privat Blerim Baloku me seli në Pejë, duke vepruar sipas propozimit për përmbaram të kreditorit me urdhrin përmbaramor P.nr.296/23 të dt. 15.05.2023 e ka lejuar përmbaramin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim duke e kontestuar urdhrin e lejuar për përmbaram me arsyetimin se në këtë rast kemi të bëjmë me një vazhdim të procedurave dhe obligimeve që ka marrë kreditori nga kontraktuesit e shërbimeve, e që ende pa i përfunduar mirë punën kërkon shpërblimin e pjesshëm. Tutje ka shtuar se

marrëveshja e bashkangjitur është e pavërtetuar, e pavulosur të organi kompetent dhe si e tillë nuk paraqet dokument përmbarimor. Andaj, nga gjykata ka kërkuar që të aprovohet prapësimi i debitorit si i bazuar ndërsa Urdhri Përmbarimor P.nr. 296/23 i datës 15.05.2023 të anulohet. Kreditori në përgjigje ndaj prapësimit i ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit duke shtuar se ky i fundit nuk ka paraqitur asnjë provë të vetme për pretendimet e tij, dhe se qëllimi i vetëm është zvarritja e procedurës. Ka shtuar se Marrëveshja mbi Ndërmjetësimin paraqet titull ekzekutiv pasi që është lëshuar nga ndërmjetësuesi i licencuar, ndërsa debitori, nuk ka përmbushur detyrimet nga kjo marrëveshje në afat prej 15 ditësh nga nënshkrimi i saj. Ka shtuar se marrëveshja në fjalë përmban vërtetimin mbi ekzekutueshmërinë, andaj është e përshtatshme për përmbarim. Me kërkesë që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar ndërsa Urdhri Përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë –Departamenti për Çështje Ekonomike pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar andaj u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi me arsyetim se sipas nenit 21 të LPP-së, “Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”. Ndërsa, me nenin 22, pika 1.4 të LPP-së, si një nga dokumentet përmbaruese përcaktohet “marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit ne pajtim me Ligjin mbi ndërmjetësimin”. Gjykata në rastin konkret ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor Marrëveshje e ndërmjetësimit nr. 021/2022 të datës 27.12.2022 mbi bazën e së cilës është lejuar përmbarimi, dhe gjeti se palë kontraktuese, përkatësisht kreditor në këtë marrëveshje paraqiten S.H., M.SH., Q.B., S.S. dhe H.B. të përfaqësuar nga avokat Labinot Vata, si dhe Komuna e Fushë Kosovës në anën tjetër në cilësi të debitorit .Në këtë drejtim, Gjykata e shkallës së parë gjen se kreditori i listuar në propozimin për përmbarim avokat Labinot Vata, nuk është palë në marrëveshjen e ndërmjetësimit por se i njëjti ka vepruar në cilësi të autorizuarit të palëve, prandaj i njëjti nuk është i autorizuar që të kërkoj realizimin e detyrimit monetar prej 312.00 EUR, pasi që kjo kërkesë monetare i është njohur palëve pjesëmarrëse në procedurën e ndërmjetësimit si shpenzim për përpilimin e padisë nga ana e përfaqësuesit të autorizuar. Si rrjedhojë, avokat Labinot Vata ka mundur të kërkoj realizimin e kërkesave monetare që derivojnë nga kjo marrëveshje vetëm

në emër dhe për llogari të palëve kreditore në marrëveshjen e ndërmjetësimit, por jo në cilësinë e tij personale. Po ashtu ka shtuar se në rastin konkret ka shqyrtuar dokumentin përmbartimor Marrëveshje e ndërmjetësimit nr. 021/2022 e datës 27.12.2022 mbi bazën e së cilës është lejuar përmbartimi, dhe gjeti se palë kontraktuese, përkatësisht kreditor në këtë marrëveshje paraqiten personat fizik S.H., M.SH., Q.B., S.S. dhe H.B., të përfaqësuar nga avokat Labinot Vata si dhe Komuna e Fushë Kosovës në anën tjetër në cilësi të debitorit, po ka gjet se kreditori i listuar në propozimin për përmbartim avokat Labinot Vata, nuk është palë në marrëveshjen e ndërmjetësimit mirëpo që i njëjti ka vepruar në cilësi të autorizuarit të palëve, ashtu që i njëjti nuk është person i autorizuar që të kërkoj realizimin e detyrimit monetar prej EUR 312.00 ndaj debitorit Komuna e Fushë Kosovës, ngase nuk është titullar të se drejtës së përcaktuar në dokument përmbartimor, përderisa kërkesa monetare i është njohur palëve pjesëmarrëse në procedurën e ndërmjetësimit si shpenzim për përpilimin e padisë nga ana e përfaqësuesit të autorizuar. Andaj meqenëse ekzekutimi i dokumentit përmbartimor mund të lejohet vetëm në dobi të personit i cili sipas dokumentit përmbartimor është i autorizuar të kërkoj përmbushjen nga debitori i përcaktuar në dokument përmbartimor, në rastin konkret vetëm në dobi të palëve në marrëveshje dhe jo kreditorit si në propozim për përmbartim, gjykata vlerëson se prapësimi i debitorit gjen mbështetje në nenin 71, paragrafi 1, pika 1.6, të LPP-së, me të cilin përcaktohet se “prapësimi mund të bazohen vetëm nëse”, ndër të tjera, “kreditori nuk është i autorizuar të kërkojë përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartues, gjegjësisht ai nuk është i autorizuar të kërkojë përmbartimin kundër debitorit”. Rrjedhimisht, edhe urdhri përmbartimor duhet të anulohet për ngase kreditori në propozim për përmbartim nuk e ka cilësinë e kreditorit në dokumentin përmbartimor mbi bazën e të cilit është lejuar përmbartimi.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se Gjykata e Shkallës së Parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale, Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përbarim, dokument përbarimor me marrëveshjen e ndërmjetësimit duke ju referuar nenit 21 të LPP-së, “Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”. Ndërsa, me nenin 22, pika 1.4 të Ligjit për procedurën përbarimor, lidhur me nenin 5.1 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit mbi procedurën përbarimore, është përcaktuar si dokument përbarimor edhe marrëveshja e lidhur në procedurë të ndërmjetësimit në pajtim me Ligjin mbi ndërmjetësimin. Por, meqenëse ekzekutimi i dokumentit përbarimor mund të lejohet vetëm në dobi të personit i cili sipas dokumentit përbarimor është i autorizuar të kërkojë përmbushjen nga debitori i përcaktuar në dokument përbarimor, në rastin konkret vetëm në dobi të palëve në marrëveshje dhe jo kreditorit si në propozim për përbarim, edhe kjo gjykate vlerëson se prapësimi i debitorit gjen mbështetje në nenin 71, paragrafi 1, pika 1.6, të LPP-së, me të cilin përcaktohet se “*prapësimi mund të bazohen vetëm nëse*”, ndër të tjera, “*kreditori nuk është i autorizuar të kërkojë përbarimin në bazë të dokumentit përbarues, gjegjësisht ai nuk është i autorizuar të kërkojë përbarimin kundër debitorit*”, ngase kreditori në propozim për përbarim nuk e ka cilësinë e kreditorit në dokumentin përbarimor mbi bazën e të cilit është lejuar përbarimi.

Pretendimi ankimor i kreditorit se gjykata ka bërë shkelje të dispozitave kur ka vendosur mbi mospranimin e dokumentit përbarimor me marrëveshjen e ndërmjetësimit. Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë një pretendim të tillë nuk mund ta pranojë si të bazuar, ngase sipas dispozitave të lartcekura nga kjo marrëveshje personi i tretë në këtë rast avokati Labinot Vata nuk është autorizuar të kërkojë përbarimin kundër debitorit dhe nuk mund të pranohen si dokumente i besueshëm, në bazë të cilave mund të zhvillohet procedura përbarimore. Nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 71, paragrafi 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

Numri i lëndës: 2024:011688
Datë: 26.06.2024
Numri i dokumentit: 05861834

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e shkallës së dytë

K.Dh.Sh II.nr.983/24, me datë 26.06.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitja Ymeri